

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbimi I sigurisë në objekte“

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV 75241000-7 - Shërbimet e sigurisë publike, 79710000-4 - Shërbime të sigurimit

VLERA E FONDIT LIMIT 49,225,833.33 (dyzetë e nëntë milion e dyqind e njëzetë e pesë mijë e teteqind e tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre) leke pa TVSH ose 515,615.72 (peseqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë pike shtatëdhjetë e dy) Euro pa Tvsh. (Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 18.05.2026, 1 euro = 95.47 All)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike, Shkoder** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera se fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar "Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën", "Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.", si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e kufizuar të operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohej deri në tre vitet e fundit financiare.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2023-2024-2025 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2025**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik

ushton apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentimi: Në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në KREU II, TAKSAT VENDORE, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ushton aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, **nënkategoria 1.3.A**, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.2** është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar dhe Udhezimin nr.130 date 05.03.2018”Per funksionimin e shërbimit privat te sigurise fizike”

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë profesionale të titullarit të subjektit konform Ligjit nr. 75 datë 10.07.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.3** është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim”* nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Udhezimit nr.150 date 16.08.2024 ”Per funksionimin e shërbimit privat te sigurise fizike”

2.3.4. Operatori Ekonomik *ofertues* duhet të vërtetoje që disponon Licensë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP) konform Ligjit Nr. 54/2024 datë 30.05.2024 ”Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të vlefshëm me fushë mbulimi në qarkun ose qytetet ku ndodhen objektet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.4** është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim”* nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjit Nr. 54/2024 datë 30.05.2024 ”Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Udhezimit nr. 150 date 16.08.2024 ”Per funksionimin e shërbimit privat te sigurise fizike”, Rekomandimit te perbashket te APP dhe KPP nr.15166 prot date 20.12.2017

2.3.5. Operatori ekonomik duhet te disponojnë Qendër Kontrolli në Qarkun Shkoder.Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin Akt Miratimi të lëshuar nga DVP Shkoder sipas Udhezimit Nr. 150 dt. 16.08.2024 te Ministrit te Brendshem “Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.5** është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”* nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të Udhezimit nr. 150 dt. 16.08.2024 ”Per funksionimin e shërbimit privat te sigurise fizike”,Rekomandimit te perbashket te APP dhe KPP nr.15166 prot date 20.12.2017.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqese dokumentin e Performaces mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik leshuar në vitin 2026.

Per kete duhet të paraqese vertetim nga Drejtoria e Policise se Qarkut Shkoder ku jepet informacioni i meposhtem.

- Numrin e punonjesve të shërbimit të certifikuar, jo më pak se 12 punonjes të çertifikuar sipas ligjit 75/2014 ” Per shërbimin Privat të Sigurise Fizike”

- Grup të gatsuem 6 gjashte punonjes 24 në 24 ore dhe operatore në Zyren e Menaxhimit të Shërbimeve 5 punonjës 24 ore”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.6** është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të Udhezimit nr. 150 dt. 16.08.2024 ”Per funksionimin e shërbimit privat të sigurise fizike”,Rekomandimit të perbashket të APP dhe KPP nr.15166 prot date 20.12.2017.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë personelin e nevojshëm dhe vertetimet e nevojshme profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Eshte kerkuar numri i disponimit të 12 punonjesve duke patur parasysh që shërbimi do të kryhet duke monitoruar kamerat dhe sistemet e alarmit nga salla e kontrollit duke patur parasysh punonjesit e grupit të gatsuem dhe operoret e salles së kontrollit.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

a.Operatori ekonomik duhet të paraqese Çertifikatën e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A lëshuar nga QKB.

b.Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet kete pjese të stafit 12 punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave nga të cilët:

- Pergjegjes shërbimi 1 punonjës të kategorisë 1.3.A
- Operator në Zyren e Menaxhimit 5 punonjës,
- Punonjes për verifikimin e sinjaleve të alarmit grup të gatsuem 24 në 24 ore

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1-Çertifikatat e punonjësve të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Shkoder për nënkategorinë 1.3A.

2- Listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhura nga punësimi të konfirmuara nga organet tatimore për muajin e fundit)

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Kërkesa e mësipërme **2.3.6/a dhe b** është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim” nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Udhezimit nr. 150 dt. 16.08.2024 ”Per funksionimin e shërbimit privat te sigurise fizike”,Rekomandimit te perbashket te APP dhe KPP nr.15166 prot date 20.12.2017. Referuar udhezimit 150 percaktohet Pergjegjesi I Shërbimit dhe “SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn”. Kreu VII germa E pika 8 percakton Shërbimi në Qendrën e Kontrollit kryhet nga punonjës shërbimi (operator) pa ndërprerje, gjatë 24 orëve, me tre turne. $1.66 \text{ punonjes per turn} \times 3 \text{ turne} = 4.98 \text{ punonjes}$. Ky eshte numri minimal I punonjesve te kerkuar pasi cdo SHPSF e ka detyrim ligjor te kete 1 pergjegjes, 5 operator dhe 6 persona Grup I gatshem.

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

3 automjete dhe 3 Motora për verifikimin e sinjaleve të alarmit shoqëruar dhe me leje drejtimi të drejtuesit të mjetit, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qera.

Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Leje e Qarkullimit,aktkolaudimin dhe policen e sigurise se automjetit ne pronesi te shoqerise
- Ne rastin kur automjeti eshte marre me qera, dokumentet e mesiperme duhet te shoqerohen edhe me Kontraten noteriale te marrjes me qera.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

AK e gjykon te nevojshme qe per realizimin e shërbimit sipas termave te references kerkohe te operatori ekonomik te disponoje 3 automjete dhe 3 Motora per raste emergjente.

Duke gene se shërbimi kërkohet ne te gjithë territorin e Bashkise Shkoder, ne Qytet dhe ne 7 njesi administrative shkollat e te cilave variojne nga 10 km deri ne 35 km largesi tre makina dhe tre

motora është numri minimal i kërkuar. Makinat janë llogaritur për kryerjen e verifikimeve në Njësiti administrative ndërsa motorat në Qytet.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të vertetojë se ka në stafin e tij pranohet mundësia e disponimit të tyre edhe nëpërmjet kontraktimit (pra jo domosdoshmërisht të figurojnë në listëpagesat e operatorëve ekonomikë):

-Te pakten 1 (nje) inxhinier elektronik ose informatik.

-Jo më pak se 2 (dy) punonjës të trajnuar për sistemet e alarmit, për të cilët operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikate trajnimi nga kompani të licencuara.

-Jo më pak se 2 (dy) punonjës të çertifikuar në fushën e CCTV nga një prodhues kamerash vendas/ndërkombëtar ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, apo certifikata apo me deshmë ekuivalente të formimit profesional, të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre me qëllim mirëmbajtjen e sistemit të kamerave

Per të provuar kriteret e mesiperme operatori ekonomik duhet të paraqese:

- diplomat përkatëse për inxhinierin elektronik ose informatik

- (listëpagesat e sigurimeve shoqërore për gjithë stafin e sipërkërkuar sipas formatit E-Sig për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku punonjësit e kërkuar duhet të figurojnë në këto listëpagesa të siguruar me kodin përkatës për muajin e fundit

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.5 është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim” nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Eshtë kërkuar që operatori ekonomik të disponojë ose me kontraktim staf të nevojshëm duke patur parasysh numrin e madh të kamerave dhe sistemeve të alarmit që do vendosen/mirembahen si dhe shtrirjen në të gjithë territorin e Bashkisë Shkoder.

2.3.10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë nëpërmjet një deklarate se merr përsipër montimin e të gjitha pajisjeve të sigurisë: DVR, Kamera dhe Sisteme Alarmi, dhe zgjidhjen e të gjitha defekteve të sistemit të kamerave, alarmit etj në kohë reale.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës, duke synuar garantimin e realizimit të shërbimit sipas standardeve të kërkuara ligjore, teknike dhe operationale, si dhe duke siguruar konkurrencë të hapur, të paanshme dhe mosdiskriminuese ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Kërkesat teknike të përcaktuara janë në përpjesëtim të drejtë me objektin e prokurimit dhe janë vendosur mbi bazën e nevojave konkrete të autoritetit kontraktor për garantimin e vazhdimësisë, cilësisë, sigurisë dhe eficiencës së shërbimit.

Specifikimet teknike nuk përmbajnë asnjë referencë ndaj markave specifike, origjinës, patentave, prodhuesve apo operatorëve ekonomikë të veçantë, me qëllim shmangien e çdo kufizimi artificial të konkurrencës dhe krijimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrje për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

Kërkesat e përcaktuara lidhen drejtpërdrejt me kapacitetet teknike dhe organizative të nevojshme për realizimin korrekt të kontratës, duke marrë në konsideratë standardet e sigurisë, legjislacionin në fuqi, kushtet operative të autoritetit kontraktor dhe garantimin e një niveli të përshtatshëm performance gjatë zbatimit të shërbimit.

Gjithashtu, në hartimin e specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë parimet e proporcionalitetit, efektivitetit dhe përdorimit eficient të fondeve publike, duke vendosur vetëm kërkesa të domosdoshme dhe të justifikuara për realizimin me sukses të objektit të kontratës.